



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 7338 Prot.

Fier, më 18.06.2025.

PROJEKT VENDIM

Nr. 67, datë 18.06. 2025

Miratimi i dokumentit “Plani Vendor i Emergjencave Civile, bashkia Fier” i rishikuar dhe i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, planin e qarkut dhe planet vendore për emergjencat civile të bashkive fqinje sipas kërkesave të nenit nr.14 “Planet për emergjencat civile” të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Në mbështetje të nenit nr. 3, “Misioni i vetëqeverisjes vendore”, të nenit nr. 9, “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, nenit nr.29 “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit nr. 14 “Planet për Emergjencat Civile”, nenit nr.12 “Harmonizimi i planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”, nenit nr. 30 “Bashkitë”, shkronja “ç”, të nenit nr. 67, “Inspektimi” shkronja “b” si edhe të nenit nr.68 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, për **rishikimin dhe miratimin** e dokumentit “**Plani Vendor i Emergjencave Civile**”, i rishikuar, Bashkia Fier,

PROPOZON:

1. Miratimin e dokumentit “**Plani Vendor i Emergjencave Civile, bashkia Fier**” i rishikuar dhe i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, planin e qarkut dhe planet vendore për emergjencat civile të bashkive fqinje sipas kërkesave të nenit nr. 14 “**Planet për emergjencat civile**” të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
2. Ky dokument të konsiderohet si një dokument themelor për planifikimin dhe zbatimin e politikave për parandalim dhe minimizim fatkeqësish dhe për zhvillimin urban në territorin e Bashkisë Fier. Dokumenti të publikohet dhe të bëhet i aksesueshëm për të gjitha Drejtoritë përkatëse dhe për publikun, si dhe të përdoret si referencë në hartimin e planeve dhe strategjive të tjera zhvillimore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria Juridike.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip **BANI**

Drejtoria Juridike
Esmeralda **KAPLLANAJ**

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera **ÇINA**

KRYETARI
Armando **SUBASHI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR**

Vasil **BREGU**

